



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 502/4 Prot

Tiranë, më 13.09.2022

V E N D I M

Nr.115, datë 13.09.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit për shpalljen #4031 – “Specialist në Degën e Thesarit Gjirokastrë”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbi trajtimin e informacionit, për vlerësim të padrejtë në dy procedura konkurrimi,

VËREJ SE:

Në informacionin e regjistruar me nr. 502 prot., datë 13.6.2022, konkurrenti *****,
pretendon se eliminimi i tij në procedurën e konkurrimit # **4031**, të publikuar në faqen zyrtare të DAP, është i padrejtë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mbledhur gjatë zhvillimit të procesit të verifikimit, konstatohet që konkurrenti në fjalë, ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në konkurrim nëpërmjet procedurës për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, me kod # **4031** – “Specialist në Degën e Thesarit Gjirokastrë” - Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Bachelor”. Në fund të këtij procesi, konkurrenti në fjalë nuk është shpallur fitues.

Duke mos qenë dakord me këtë fakt, konkurenti ***** është ankuar përpara njësisë përgjegjëse DAP, duke informuar njëherësh Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ku ka parashtruar pretendimet dhe kundërshtitë e tij në lidhje me vlerësimin. Ai pretendon se nuk është vlerësuar drejt nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit (KPP), përse i takon vlerësimin për intervistën me gojë dhe jetëshkrimin, duke marrë më pak pikë nga sa meriton.

Për të sqaruar këto pretendime, u kërkua nga Departamenti i Administratës Publike informacioni i nevojshëm dhe në vijim të komunikimit, institucioni i DAP është përgjigjur me anë të shkresës së regjistruar me nr. 502/1 prot., datë 22.06.2022 “*Kthim përgjigje*”, duke informuar Komisionerin për përfundimin e hetimit për rastin në fjalë, si dhe ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me procedurën dhe konkluzionet e arritura.

Nga përmbajtja e aktit si më sipër, referohet se Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) është mbledhur dhe ka shqyrtuar ankesën e kandidatit *****. Pas rivlerësimit të jetëshkrimit, kandidati është vlerësuar me të njejtat pikë, për secilën nga kërkesat e analizuar (*vlerësimi për arsimin, përvojën dhe trajnimet*), duke patur parasysh kërkesat e posaçme për pozicionin e punës dhe dokumentacionin në dosjen e kandidatit.

Po kështu, në lidhje me pretendimin mbi përmbajtjen e pyetjeve të testimit me shkrim, sqarohet se, KPP harton pyetjet për këtë fazë të konkurrimit, në përputhje me karakteristikat e pozicionit të punës, parashikuar në përshkrimin e punës për pozicionin e kërkuar. Korrigjimi i testimit me shkrim kryhet nga sistemi kompjuterik, i cili gjeneron rezultatin e kandidatit. Duke qenë se në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk rezultoi ndonjë pasaktësi nga sistemi, ky organizëm i ka qëndruar të njejtë rezultat.

Gjithashtu, përse i takon vlerësimin të intervistës së strukturuar me gojë, konstatohet se përmbajtja e pyetjeve për këtë fazë të testimit, lidhet me njohuritë dhe aftësitë që nevojiten drejtpërdrejt për pozicionin e punës. Duke qenë se kandidati në fjalë kishte zgjedhur që intervista të regjistrohej, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, ka ridëgjuar dhe rivlerësuar intervistën e strukturuar me gojë dhe në përfundim ka vendosur t’i qendrojë të njejtë vlerësim.

Pas sqarimit të gjithë sa më sipër, u vijua me verifikimin e pretendimeve për shkelje ligjore, gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit, në përfundim të të cilit rezultoi që:

1. Në lidhje me pretendimin se nuk është vlerësuar siç duhet nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP) përse i takon jetëshkrimin, duke marrë më pak pikë nga sa meriton, arrihet në konkluzionin se pretendimi është i pabazuar.

Kriteret e përgjithshme të vlerësimit të kandidatëve përcaktohen sipas pozicionit në të cilin kryhet konkurrimi, e shprehur kjo në nenin 23, të ligjit nr. 152 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar. Po kështu, në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil...”, janë përcaktuar shprehimisht, përbërja e komiteteve sipas kategorisë së pozicionit të punës, si dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve.

Konkretisht, në rastin konkret, të 5 (pesë) anëtarët e KPP, janë përzgjedhur në përputhje me kërkesat e Kreut II “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”. Secili nga anëtarët e KPP, ka vlerësuar çdo pyetje me pikë dhe në përfundim, vlerësimi i kandidatit është bërë me vendim unanim.

Nga verifikimi i akteve konstatohet se janë respektuar të gjitha kërkesat dhe procedurat ligjore, duke filluar nga shpallja me kriteret që duhej të plotësonin kandidatët pjesëmarrës, deri te njoftimi individualisht i kandidatëve që kanë konkurruar dhe publikimi i vendimit të përzgjedhjes së kandidatit fitues me më shumë pikë.

Në vijim, kandidati *****, ka ushtruar edhe të drejtën e ankimit në KPP, për rezultatin e pikëve prej nga ku rezulton se, kjo e fundit ka bërë një rivlerësim të elementëve të jetëshkrimit, ku janë përfshirë: arsimi, eksperiencia, trajnimet e lidhura me fushën, vlerësimi më i fundit i punës, duke patur parasysh edhe kërkesat e posaçme për pozicionin e punës dhe dokumentacionin në dosjen e kandidatit. Në fund të rivlerësimit rezultati nuk ka ndryshuar.

Duke vlerësuar gjithë sa më sipër, arrihet në konkluzionin se pretendimi i konkurrentit *****, për vlerësim të pasaktë të jetëshkrimit rezulton i pambështetur ligjërisht.

2. Po kështu, edhe pretendimi i ngritur se, përmbajtja e pyetjeve të testimit me shkrim kishte paqartësi të cilat pengonin kuptimin e drejtë të pyetjeve, vlerësohet i pambështetur në ligj.

Në këtë rast sqarojmë se, hartimi i pyetjeve të vlerësimit me shkrim, mbështetur në pikën 9, të kreut IV, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe në seksionin III/3, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP, është në diskrecion të Komitetit të Përhershëm të Pranimi. Pyetjet në tezën e provimit me shkrim janë të organizuara me alternativa dhe korrigjimi i tyre nuk bëhet manualisht nga anëtarët e KPP, por nga sistemi kompjuterik, i cili

në fund të skanimit gjeneron rezultatin për secilin kandidat. Kjo mënyrë vlerësimi shmang çdo subjektivizëm në vlerësimin e testimit me shkrim.

3. Gjithashtu i padrejtë vlerësohet edhe pretendimi përta i takon përmbajtjes dhe fushës së pyetjeve për fazën e intervistës së strukturuar me gojë.

Nga verifikimi i akteve që materializojnë procesin e intervistës së strukturuar, kostatohet se, sipas përcaktimeve në VKM nr. 243, datë 18.3.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP, Komiteti i Përhershëm i Pranimin ka hartuar pyetjet për intervistën me gojë, të njëjta për të gjithë, në përshtatje me kërkesat e posaçme të vendit të punës dhe aftësitë/njohuritë që duhet të zotërojë konkurrenti për pozicionin e punës.

Intervista e konkurrentit në fjalë është regjistruar sipas kërkesës së këtij të fundit. Pasi anëtarët e KPP e kanë ridëgjuar/rivlerësuar atë dhe në përfundim është arritur në të njëjtin rezultat.

Nga gjithë sa më sipër, arrihet në konkluzionin se në procedurën e konkurrimit me shpalljen #4031 – *“Specialist në Degën e Thesarit Gjirokastër”* - Lloji i diplomës *“Shkenca Ekonomike”*, niveli minimal i diplomës *“Bachelor”*, njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimin (KPP), kanë vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 *“Për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese...”* të Departamentit të Administratës Publike.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë për moskualifikimin e nëpunësit ***** në procedurën e konkurrimit, për pozicionin e

punës me kod #4031 “*Specialist në Degën e Thesarit Gjirokastër*” dhe, meqënëse nuk gjenden elementë kundraligjshmërie në administrimin e këtij konkurrimi, të bëhet arkivimi i çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike dhe konkurrenti *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha